



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## Study program **E Drejta Penale (2022/2023)**

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-MLAWPEN120C
Titulli	Magjistër i shkencave juridike / Drejtimi: E drejta penale
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-1779/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	10.06.2022

## Përshkrimi i programit

Programi studimor *E Drejta Penale* synon të ofrojë një gamë të moduleve që do të përbëjnë bazën e informacioneve dhe të dijeve të avancuara mbi lëndët juridike penale me qëllim të aftësisht profesional të studentëve për profesionet themelore juridike që lidhen me këtë lëm duke ofruar njohuri solide, të veçanta dhe sistematike mbi institutet dhe konceptet e të drejtës penale në RMV dhe njohuri krahasuese nga rajoni dhe BE-ja.

## Karriera

Diploma e Fakultetit Juridik njihet nga Oda e Avokatëve dhe Noterëve në RMV. Titujt profesionalë të avokatëve dhe të noterëve kërkojnë regjistrim formal në këto oda. Diploma e Fakultetit Juridik u mundëson studentëve një qasje në organet shtetërore, sidomos në organet gjyqësore, si: gjykatat dhe prokuroritë publike. Fakulteti Juridik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë për trajnimin e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë në RMV. Studentëve që do të kenë ambicie të merren me punë hulumtuese shkencore, Fakulteti juridik i UJEL-së, u mundëson vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë (studime të doktoratës).

## Rezultatet e të mësuarit

### Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të avancuara teorike, empirike dhe krahasimtare për shkencat penale juridike, si dhe njohuri të avancuara për legjislacionin dhe praktikën gjyqësore në sferën e parandalimit të kriminalitetit.
- Ka kuptim të jashtëzakonshëm për problemet që lidhen me krimin dhe sanksionet penale, veçanërisht në fushat e të drejtës krahasimtare penale dhe të së drejtës procedurale penale, kriminologjisë dhe penologjisë teorike dhe zbatimore, krimin të organizuar dhe shkencave forenzike (mjekësia, psikiatria dhe psikologjia gjyqësore).
- Ka njohuri specifike për teknikat dhe metodat e avancuara të hulumtimit në sferën e të drejtës penale dhe të procedurës penale.

### Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Identifikon dhe analizon problemet komplekse në fushën e të drejtës dhe procedurës penale, kështu që mund të marrë pjesë aktive në të gjitha shkallët e procedurës penale si dhe interpreton çështje të avancuara të legjislacionit penal (duke përfshirë këtu edhe punën si gjyqtar, prokuror ose avokat, pas fitimit të kualifikimeve të nevojshme sipas legjislacionit të RMV-së).
- Përdor njohuritë e fituara përmes punës kërkimore në procesin e zgjidhjes së problemeve me anë të krahasimit të praktikave dhe zgjidhjeve në sferën e parandalimit të kriminalitetit.

### **Aftësitë për të vlerësuar**

- Ka mendim më të zhvilluar kritik përmes metodës së analizës dhe të krahasimit.
- Zhvillon shkathtësi për zgjidhjen e problemeve përmes praktikës së zgjidhjes së rasteve më komplekse nga juridiksioni dhe praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare.

### **Aftësitë e komunikimit**

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në sferën e shkencave juridike-penale.
- Sjell vendime të avancuara dhe punon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive si në fazën parapenale dhe në procedurën gjyqësore.
- Angazhohet aktivisht në argumentimin dhe debatin shkencor.
- I përdor gjuhët zyrtare të universitetit si dhe ka shkathtësi të avancuara të teknologjive të informimit në punën shkencore.

### **Aftësitë e të mësuarit**

- Zhvillon rregullore për punë kërkimore që përdoret në profesionin e tij.
- Zhvillon një praktikë të mësimit të vazhdueshëm duke u angazhuar në trajnimin e personave që punojnë në institucionet shtetërore për parandalimin e kriminalitetit.

## **Lista e lëndëve**

### **Semestri 1**

- [CM157] [6.0 SETK] **E drejta penale (program i zbatuar)**
- [MCCR2030] [6.0 SETK] **E drejta penale ndërkombëtare**
- [MCCR1040] [6.0 SETK] **Kriminologjia**
- [MCCR2040] [6.0 SETK] **Kriminalistikë**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### **Semestri 2**

- [CM158] [6.0 SETK] **E drejta procedurale penale (program i zbatuar)**
- [MCCR2010] [6.0 SETK] **Penologjia**
- [MCCR3030] [6.0 SETK] **E drejta e kundërvajtjeve**
- [CM159] [6.0 SETK] **Delikuenca e të miturve**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### **Semestri 3**

- [MCCR3040] [6.0 SETK] **E drejta penale e krahasuar**
- [MCCR3010] [6.0 SETK] **Viktimologjia**
- [MCCR1120] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### **Semestri 4**

- [MCCR4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## **Description of courses**

## Lëndë obligative

- **E drejta penale (program i zbatuar)**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njihen me institutet dhe normat penale, si dhe me parimet mbi të cilat është ndërtuar e drejta penale. E drejta penale si e drejtë pozitive është sistem normash me anë të së cilave sjellje të caktuara të njerëzve parashihen si vepra penale për të cilat vepra janë të parapara dënime dhe sanksione tjera shtrënguese nga ana e shtetit dhe janë përcaktuar kushtet dhe mënyrat e zbatimit të tyre.

- **E drejta penale ndërkombëtare**

Pas përfundimit me sukses të lëndës, nga studentët pritet të kenë fituar njohuri solide mbi nocionet dhe lëndën e kësaj disipline, normat në DPN, mbi pushtetin represiv dhe juridiksionin e shteteve, mbi ekstradimin, azilin, transferimin e procedurës penale, bashkëpunimin dhe ndihmën penale juridike, korpusin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe juridiksionin të instancave ndërkombëtare penale.

- **Kriminologjia**

Përvetësimi i njohurive të avancuara mbi lëndën e studimit të kriminologjisë dhe të institucioneve kryesore kriminologjike, çështjet dhe tendencat bashkëkohore, si dhe të bëhen studime mbi ndikimin e faktorëve të ndryshëm në kryerjen e veprave penale, ekzaminimet kriminologjike lidhur me kryesin dhe viktimën e veprës penale si dhe identifikimi dhe analizimi çështjeve bashkëkohore kriminologjike.

- **Kriminalistikë**

Specializimi në këtë fushë është i nevojshëm sidomos për ato kuadro që do të punojnë në organet e drejtësisë – në gjykata, prokurori publike dhe në policinë gjyqësore. Kriminalistika në thelbin e saj e ka legjislacionin penal material dhe procedural, si dhe aktet nënligjore që burojnë prej zbatimit të tyre. Çdo qenie ligjore e veprës penale përmban në vete përcaktimin e tërësisë së fakteve dhe të rrethanave që janë relevante për zgjidhjen e gjithanshme dhe të drejtë të rastit penal.

- **E drejta procedurale penale (program i zbatuar)**

E Drejta e Procedurës Penale është disiplinë shkencore që studion normat juridike që rregullojnë pozitën e palëve, si dhe kompetencat e palëve dhe subjekteve tjera pjesëmarrëse në procesin penal, llojin, formën dhe kushtet për ndërmarrjen e veprimeve procedurale. Lëndë studimi është sistemi i mjeteve juridike-të rregullta dhe të jashtëzakonshme, si dhe procedurat e veçanta.

- **Penologjia**

Qëllimi i kësaj lënde është të analizohet mënyra e ekzekutimit të së drejtës penale, gjegjësisht ekzekutimi i sanksioneve penale. Lënda e studion procedurën e ekzekutimit të dënimit me burg, si dhe ekzekutimin e sanksioneve tjera përmes analizimit të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve dhe Ligjit për shërbimin e provës.

- **E drejta e kundërvajtjeve**

Qëllimi i lëndës konsiston në fitimin e njohurive të avancuara për të drejtën e kundërvajtjeve si disiplinë shkencore, si dhe për pjesën materiale dhe procedurale të saj, përfshirë këtu edhe rregullimin ligjor të kundërvajtjeve sipas Ligjit për kundërvajtje.

- **Delikuenca e të miturve**

Delikuentët e mitur janë në lidhje të ngushtë edhe me fenomenet e tjera socio-patologjike, siç janë: narkomania, alkoolizmi dhe prostitucioni, dukuri që sot përhapen pothuajse në çdo vend në botë dhe për fat të keq, ato janë të pranishme edhe në vendin tonë. Prandaj, qëllimi themelor i kësaj disipline është të zbulohen dhe të evidentohen format e reja të kësaj dukurie kriminale dhe të shpjegohen shkaqet për praninë e tyre në mënyrë që të propozohen masat e duhura për parandalim dhe represion.

- **E drejta penale e krahasuar**

Lënda i shqyrton sistemet penale të vendeve të ndryshme, përmes analizës sistematike të zgjidhjeve të ligjeve penale në kontekstin e kushteve dhe faktorëve ekzistues socialë, të tendencave zhvillimore, nivelizimit të legjislacionit penal, si dhe harmonizimin e tij me të drejtën penale në suaza të BE-së.

- **Viktimologjia**

Qëllimi i kësaj lënde është të analizohet në më tepër aspekte pozita e viktimës së veprës penale. Do të studiohet fenomenologjia dhe etiologjia viktimologjike, forma, vëllimi, struktura dhe dinamika e viktimizimit, si dhe faktorët e

ndryshëm që ndikojnë mbi të.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Studentët do të jenë në gjendje: - T'i aplikojnë metodat kryesore juridike dhe metodat tjera hulumtuese. - Të mbledhin në mënyrë kritike dhe krijuese material kërkimorë, që është relevant dhe që citohet nga autorët në mënyrë selektive në përgjigjet e tyre. - Ta kuptojnë vëllimin e procesit të hulumtimit dhe qasjen në metoda të ndryshme të kërkimit shkencor dhe të jenë në gjendje ato t'i kritikojnë. - Ta studiojnë përmes qasjes së avancuar raportin midis teorisë juridike dhe praktikës kërkimore. - T'i aplikojnë shkathtësitë dhe njohuritë e mësuara në tezat e tyre.

- **Punimi i magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve t'i bartin shkathtësitë dhe dituritë e tyre për hulumtimin dhe hartimin e detyrës më të komplikuar – shkrimit të punimit të magjistraturës. Lënda është paraparë që tërësisht të jetë praktike dhe studentët t'i fitojnë dituritë dhe aftësitë, shkathtësitë dhe besimin e nevojshëm që t'i qasen hulumtimit dhe shkrimit të tezës. Lënda ka vetëm një rezultat kthyes – t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me efektivitet maksimal. Gjithçka që është paraparë që të bëhet ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe të stilit të shkrimit të tezës së magjistraturës duke pasur kujdes me këtë rast për ndalimin e shërbimit me mjetet e palejueshme, siç janë: plagjiatura dhe shkelja e të drejtave të autorit, që ndalohen me Statutin e UEJL-së.

## Lëndë zgjedhore

- **E drejta penale evropiane**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri të reja lidhur me zhvillimin e të drejtës penale evropiane. Ata do të shkathtësohen t'i kuptojnë rrënjët e inkriminimeve të reja (prej ku rezultojnë ato, nga aktiviteti i Këshillit të Evropës, apo nga aktet juridike të BE-së). Studentët, do të njihen me mekanizmat evropianë të bashkëpunimit gjyqësor dhe policor në sferën penale, si dhe do të mësojnë për përparësitë dhe mangësitë e tyre, sidomos në sferën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Kriminaliteti kompjuterik**

Studentët do të fitojnë njohuri të avancuara mbi llojet më të reja të veprave penale që kryhen përmes kompjuterëve dhe rrjeteve të internetit si dhe me mënyrat bashkëkohore të parandalimit të krimit të tillë, që po zhvillohet gjithnjë e më shumë në shoqëritë e sotme digjitale. Do të analizohen krime të tilla si: mashtrimet kompjuterike, falsifikimet e softuerit kompjuterik, si format e tjera të abuzimit të internetit për qëllime kriminale etj. Do të analizohet legjislati vendor i posareformuar dhe ndërkombëtar dhe do të fitohen njohuri mbi standardet dhe rrjedhat botërore në këtë lëmi.

- **Kriminaliteti ekonomik**

Qëllimi i lëndës është të njohë dhe analizojë dukuritë kriminale me karakter ekonomik, shfaqjen dhe karakteristikat e tyre, ndikimin negativ shumëdimensional, lehtësinë e zbulimit dhe zgjidhjes, format e shfaqjes, si dhe institucionet që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë e luftojnë këtë krim.

- **Krimi i organizuar**

Qëllimi i lëndës është që studentët t'i pasurojnë njohuritë e tyre mbi krimin e organizuar si nocion dhe fenomen i pranishëm në sfera të ndryshme shoqërore. Në këtë kontekst do të analizohen elementet që përbëjnë situatën kriminale të karakterit të organizuar, korrupsioni si faktor kyç që ndikon në këtë lloj krimi, masat e veçanta hetuese dhe të tjera që ndikojnë në zbulimin, dokumentimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, si dhe rolin i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar.

- **Trafikimi me njerëz**

Trafikimi me njerëz është një formë e veçantë e krimit të organizuar dhe karakterizohet si skllavëri e ditëve të sotme. Ky tip serioz i krimit paraqet një shkëlqje të rëndë të të drejtave dhe lirive më thelbësore të njeriut, prandaj është i ndaluar dhe ndiqet në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, me ligjet kombëtare dhe me mekanizmat e represionit. Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me aspektet teorike e praktike të avancuara të këtij fenomeni, duke analizuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare, ligjet dhe mekanizmat vendore në këtë fushë, si dhe me të kuptuarit e praktikës vendore gjyqësore, që kanë të bëjnë me rastet e trafikimit me njerëz. Qëllimi i programit të lëndës: - Përcaktimi i veprës penale tregti me njerëz; - Identifikimi i komponentëve të kornizës gjithëpërfshirëse të luftës kundër tregtisë me njerëz; - Vlerësim i sfidave kritike lidhur me çrrënjosjen e tregtisë me njerëz në shoqërinë globale.

- **Dhuna në familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imune ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkrimohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Psikologjia gjyqësore**

Kjo disiplinë ka karakter ndihmës për shkencat e tjera juridike penale me qëllim të vlerësimit psikologjik të së vërtetës dhe të gënjeshtres në procesin gjyqësor penal ndaj të pandehurve, dëshmitarëve dhe personave të tjerë në procedurën penale gjyqësore përmes vlerësimit psikologjik të deklaratave dhe veprimeve të tyre.

- **Mjekësia ligjore**

Aftësimi i studentëve me njohuri të avancuara për shkencën forenzike ndaj veprave penale kundër jetës dhe shëndetit të njerëzve, si dhe me terminologjinë themelore që paraqet udhëzimin kyç për koordinimin dhe komunikimin ndërmjet departamenteve hetimore dhe gjyqësore. Nëpërmjet këtij moduli, studenti, do të jetë në gjendje të formulojë kërkesa, urdhëresa dhe parashtrës të tjera midis gjykatës dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore për lëshimin e urdhrave për lëndim trupor, për ekspertime mjeko-ligjore, urdhra për identifikimin e personave të gjallë, të kufomave dhe mbetjeve skeletore.

- **Politika kriminale**

Në këtë lëndë studentët do të njihen me të gjitha masat parandaluese ndaj kriminalitetit, të parashikuara në sistemin e drejtësisë penale në vend dhe më gjerë.

- **Klinika juridike - e drejta penale**

Kjo lëndë paraqet program një semestral, program për formimin e njohurive të fituara nga lëndët juridiko penale. Në këtë lëndë studentët do t'i aplikojnë njohuritë e fituara më herët nga lëndë konkrete penale, të cilat do t'i punojnë nën mentorimin e profesorit të lëndës, si dhe nën mbikqyrje të një prokurori apo avokati, me të cilët bashkërisht do të punojnë në raste konkrete më të lehta dhe do të ndihmojnë në pregaditjen e shkresave dhe ndërmarrjen e veprimeve pregaditore procedurale. Më pas, do të përsërisin materialin juridik dhe poashtu do të analizojnë burime nga vende të tjera, të cilat punojnë me klinika juridike.

- **E drejta penale mjekësore**

E Drejta Penale Mjekësore është një fushë speciale brenda të drejtës mjekësore si degë e veçantë ligjore në përgjithësi dhe si disiplinë e ndare e drejtës penale. Shkenca e së drejtës penale mjekësore përbëhet prej pjesës së përgjithshme dhe pjesës speciale. Pjesa e përgjithshme studion sistemin e të drejtës mjekësore; burimet, metodat dhe vendin e kësaj të drejte në sistemin social dhe shkencor; mbrojtja e të drejtave të pacientit në suaza të së drejtës penale, etj. Çështjet specifike, aspektet ligjore të llojeve të ndryshme intervenimeve mjekësore u nënshtrohen një pjese të veçantë të kësaj shkence. Këto janë: ofrimi i kujdesit mjekësor, eutanazia, aborti, ekspertiza mjekësore, kujdesi mjekësor, transplantimi, gabimet mjekësore, teknologjitë riprodhuese, klonimi, manipulimi gjenetik etj. E drejta penale mjekësore përfshin çështjen e statusit, të drejtave dhe mënyrën e trajtimit të personave me sëmundje mendore dhe në përgjithësi, trajtimi i personave të pallogaritshëm, masat e sigurisë, mbrojtja e integritetit fizik dhe mendor, mbrojtja e së drejtës për jetë, përjashtimi i paligjshmërisë në ndërhyrjet mjekësore, etj.